

AKT THEMELIMI

i Shoqërisë REFAB Construction Shpk

Sot, në Tiranë, më 01/03/2021, unë ortaku i vetem **Festim Muharrem Troci**, hartoj Aktin e Themelimit të shoqërisë **REFAB Construction Shpk** sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar në fuqi, me dispozitat që vijojnë:

Neni 1 Themelimi

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

- 1) Emri i shoqërisë është **REFAB Construction Shpk**. (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 2) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3) Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin e saj.

Neni 2 Selia


- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane, Rruga Frederik Shiroka, Kulla Nr.3, Kati i pare, Dyqani 19.
- 2) Shoqëria mund të themelojë degë në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin.

Neni 3 Objekti

Objekti i Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- 1) Ne fushen e ndertimit : Ndërtime civile, turistike industriale dhe natyrave te tjera, ndertim objektesh banimi dhe sherbimesh, ndertim objektesh publike e jopublike, ndertim objektesh turistike, ura, rruge, hekurudha. Montim konstruksionesh metalike, aktivitete te ndryshme ne fushen e ndertimit dhe cdo

Adresa: Tirane, Rruga Frederik Shiroka, Kulla Nr.3, Kati i pare, Dyqani 19
Email: info@refabconstruction.com



aktivitete tjeter qe konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimeve të biznesit e që nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi.

Neni 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5
Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm

- 1) Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në vlerën 100.000,00 (njëqind mijë) Lekë, i përbërë nga 1(një) pjesë me vlerë nominale të një pjese prej 100.000,00 (njëqind mijë) lekësh.
- 2) Ortaku i Shoqërisë është Z. Festim Troci, atësia Muharrem i dtl. 06/04/1979 lindur në Draj, Rec dhe banues në Tiranë identifikuar nga karta e identitetit me nr. 036409926. Numer personal H90406075J

Neni 6
Ortakët

Ortaku i vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

Neni 7
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:


- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë që i bashkëlidhet këtij akti.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, **Z. Festim Troci, atësia Muharrem i dtl. 06/04/1979 lindur në Draj, Rec dhe banes në Tiranë identifikuar nga karta e identitetit me nr. 036409926, numer personal H90406075J** i cilit zgjidhet për një afat për **5vjet**.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Adresa: Tirane, Rruga Frederik Shiroka, Kulla Nr.3, Kati i pare, Dyqani 19
Email: info@refabconstruction.com



NENI 8
Audituesit ligjorë

Audituesit ligjorë të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë Audituesin Ligjor.

NENI 9
Pjesmarrja

Ortaku themelues mund të vendos me vullnetin e tij, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10
Ngritja e degëve apo filialeve

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11
Ruajtja e Sekretit

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë, të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Tiranë.

NENI 13
Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi u hartua në 3 (tre) kopje, me vlerë të njëjtë juridike për t'u administruar në baze të ligjit, një kopje për t'u dorëzuar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe dy kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

ORTAKUI VETËM I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

REFAB Construction Shpk

Festim Troci



Adresa: Tirane, Rruga Frederik Shiroka, Kulla Nr.3, Kati i pare, Dyqani 19
Email: info@refabconstruction.com